

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**EcoHabitat Builders**  
**ME SELI NË TIRANË**

Sot, më date 10/11/2023, në Tiranë,

**Z. Agron Braho**, Shtetas Shqiptar, i lindur më datë 25/02/1972, në Fier, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, Leternjoftim ID nr. 035861516 dhe nr. personal H20225077P;

**Z. Gezim Kamenica**, Shtetas Shqiptar, i lindur më datë 04/10/1970, në Fier, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, Leternjoftim ID nr. 036459905 dhe nr. personal H01004099D;

**Shoqëria tregtare "Innovate Consult" shpk**, regjistruar në QKB më datë 06/11/2023, me Numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS) M32306036M, përfaqësuar nga administratori i saj znj. Adelina Shella, me nr. personal H86208110R;

Vendosën të krijojnë shoqërinë **EcoHabitat Builders**, një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat si më poshtë:

**NENI 1.**

SHOQËRIA TREGTARE **EcoHabitat Builders**, krijohet në formën e Shoqërisë tregtare sipas ligjit nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është person juridik privat Shqiptar. Zyra e kompanisë ndodhet në qytetin e Tiranës.

**NENI 2.**

**Emri i Shoqërisë**

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj me emrin tregtar: **EcoHabitat Builders shpk**.

**NENI 3.**

**Objekti i veprimtarisë ekonomike**

Shoqëria ka për objekt - në përputhje me dispozitat e ligjit - këto aktivitete:

Investime, konsulence dhe cdo aktivitet që lidhet me fushën e energjisë, projektive dhe ndertimit. Studimi, projektimi, sipermarrja zbatuese dhe/ose investimi, sipas rastit, të veprave me karakter shfrytëzimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugëve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, ujesjellesave, telekomunikacionet, ndertim tjetër i cili në përfundim përben send të paluajshëm për shkak të trupezimit në mënyrë të qëndrueshme me token ose ndertesën ku është vendosur etj. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që

siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj.

#### **NENI 4. Selia e Shoqërisë**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga "Ali Pashe Gucia", Pall.Aurora, shk.1, ap.2, Tiranë.**

#### **NENI 5. Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë do jetë me vlerë 120,000 (njëqind e njëzet mijë) lekë dhe përbëhet nga 3 kuota.

Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin fillestar, ndahet si më poshtë:

1. Z. Agron Braho mbajtës i një kuote te kapitalit themeltar me vlere 40,000 (dyzet mijë) lekë.
2. Z. Gezim Kamenica mbajtës i një kuote te kapitalit themeltar me vlere 40,000 (dyzet mijë) lekë.
3. Shoqëria tregtare "Innovate Consult" shpk mbajtës i një kuote te kapitalit themeltar me vlere 40,000 (dyzet mijë) lekë.

#### **NENI 6. Kohëzgjatja e Shoqërisë**

Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj për një periudhë kohore te pacaktuar.

#### **NENI 7. Organet drejtuese**

Referuar ligjit n. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë krijohen si më poshtë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori.

Forma dhe rregullat e organizimit të Shoqërisë janë të parashikuara në statutin e Shoqërisë.

Shoqëria fillimisht administrohet nga një Administrator i vetëm i cili do të qëndrojë në detyrë për 5 vjet, i rinovueshëm, përveç rasteve kur revokohet ose jep dorëheqjen, ose për arsye të tjera ligjore.

Administrator i Shoqërisë, do të jetë z. Agron Braho, shtetas Shqiptar, lindur më 25/02/1972, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me nr. personal H20225077P.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, publik ose privat, gjithashtu në marrëdhënie juridike me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto kompetenca në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi. Shoqëria administrohet nga një Administrator i vetëm, edhe jo ortak, ose nga disa administatore edhe jo ortakë, sipas asaj që është përcaktuar në momentin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë u është besuar disa personave, vendimi i emërimit përcakton në mënyrë alternative:

a) nëse administratorët do të funksionojnë në mënyrë kolegjiale, duke formuar kështu këshillin e administrimit;

b) nëse administrimi i është caktuar veçmas apo bashkërisht.

#### **NENI 8.**

Organizimi dhe funksionimi i Shoqërisë, hapja e zyrave apo degëve dytësore do të bëhet në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar dhe të Statutit.

#### **NENI 9.**

Punonjësit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë janë përgjegjës dhe duhet të kompensojnë kompaninë për dëmet e shkaktuara me dashje për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 10.**

##### **Ligji në fuqi**

Veprimtaria e shoqërisë do të drejtohet nga rregullat e statutit të nënshkruar nga anëtarët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 11.**

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me themelimin e shoqërisë do të zgjidhet nga ortakët në të kundërt mosmarrëveshjet do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

#### **NENI 12.**

##### **Dispozitat përfundimtare**

Akti i themelimit hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua nga anëtari përbërës, u konstatua në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe nënshkruhet pa asnjë vërejtje.

#### **ORTAKËT THEMELUES**


**Agron BRAHO**

AGRON BRAHO



**Gezim Kamenica**

GEZIM KAMENICA



Page 3 of 3

**Innovate Consult shpk**

**Adelina Shella  
Administrator**

